



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

RREGULLORE

PËR KRITERET E RISIGURIMIT

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 85/1, datë 30.09.2015

Ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 88, datë 27.06.2016

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore ka për objekt të përcaktojë kriteret mbi bazën e të cilave lidhen marrëveshje risigurimi nga shoqëritë e sigurimit që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo rregullore hartohet në mbështetje të nenit 116, pika 3, nenit 117, pika 7, 118, pika 2 dhe 119, pika 4, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Neni 3

Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) "Kontratë risigurimi" nënkupton një kontratë të lidhur midis shoqërisë së sigurimit dhe të risigurimit, që përcakton termat dhe kushtet për rreziqet që do të risigurohen.
- b) “Marrëveshje risigurimi” nënkupton një kontratë risigurimi që kryen transferimin automatik të një pjese të rreziqeve të përcaktuara në kontratë për të gjitha policat e sigurimit që mbulohen nga kontrata e risigurimit.
- c) “Risigurim fakultativ” nënkupton transferimin e një pjese të një rreziku të veçantë të siguar nga shoqëria e sigurimit te shoqëria e risigurimit, sipas një kontrate të veçantë të risigurimit.

- ç) “Risigurim jo-proporcional” nënkupton një lloj risigurimi që zhdëmton shoqërinë e sigurimit për shumën e dëmit në tejkalim të mbajtjes deri në kufirin e përcaktuar në kontratën e risigurimit.
- d) “Shtresë” nënkupton një segment horizontal të risigurimit jo-proporcional, ku përcaktohen pikat e tejkalimit dhe shuma e siguruar.
- dh) “Risigurues kryesor” nënkupton shoqërinë e risigurimit që është përgjegjëse për të negociuar dhe rënë dakord me shoqërinë e sigurimit për kushtet dhe termat e kontratës së risigurimit.
- e) “Rreziku i kreditit” nënkupton rrezikun e humbjes apo përkeqësimit të gjendjes financiare të shoqërive të risigurimit ndaj të cilëve ekspozohet shoqëria e sigurimit.
- ë) “Shkallë e kreditit” nënkupton shkallën e kreditit të shoqërisë së risigurimit të vlerësuar nga një agjenci klasifikuese.
- f) “Niveli i cilësisë së Kreditit” nënkupton klasifikimin e Cilësisë së Kreditit të shoqërive të Risigurimit në 6 nivele, duke nisur nga niveli 0, i karakterizuar me rrezik minimal krediti deri në nivelin 5, i kategorizuar me rrezik shumë të lartë krediti.
- g) “Agjenci klasifikuese” nënkupton një shoqëri të specializuar për vlerësimin e shkallës së kreditit të shoqërive të risigurimit bazuar në kapacitetin dhe mundësitë e tyre për të përmbushur në kohë detyrimet financiare.
- h) “Regjime mbikëqyrëse të barasvlefshme me Aftësinë Pagueuse II” nënkupton regjimet e mbikëqyrjes së sigurimeve në vendet që janë njohur zyrtarisht nga Komisioni Evropian dhe publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit si të barasvlefshme me regjimin Aftësia Pagueuse II të Bashkimit Evropian.
- gj) “Raporti i aftësisë paguese” nënkupton raportin e aftësisë paguese me marzhin minimal të aftësisë paguese të shoqërisë së risigurimit.

Neni 3/1 **Kritere të përgjithshme**

Shoqëria e sigurimit, për çdo vit financiar zbaton programin e nevojave për risigurim të mbështetur në vlerësimin e rreziqeve që parashikon të marrë në sigurim në baza individuale nga vetë shoqëria, si edhe nëpërmjet përfshirjes së saj në bashkësigurime apo krijimit të grupimeve të veçantë për mbulimin e rreziqeve të mëdha. Në rast të sigurimeve të kryera nëpërmjet përfshirjes së saj në bashkësigurime apo krijimit të grupimeve të veçantë për mbulimin e rreziqeve të mëdha, shoqëria është përgjegjëse për pjesën e rrezikut të marrë përsipër prej saj si rezultat i këtyre bashkëpunimeve.

Neni 4

Niveli i Cilësisë së Kreditit të Shoqërive të Risigurimit

1. Për qëllim të kësaj rregulloreje, niveli i cilësisë së kreditit të shoqërive të risigurimit do të përcaktohet bazuar në një nga mënyrat e mëposhtme:

- a) Shkallën e Kreditit të shoqërisë së risigurimit të përcaktuar jo më parë se 18 muaj para datës së fillimit të kontratës së risigurimit nga një prej agjencive të mëposhtme klasifikuese:
 - i. Standard & Poors;
 - ii. Fitch;
 - iii. Moody's;
 - iv. AM Best.
- b) Raportin e fundit të Aftësisë Pagueuse të llogaritur jo më parë se 12 muaj nga data e fillimit të kontratës së risigurimit, për shoqëritë e risigurimit që nuk kanë shkallë krediti prej agjencive të mësipërme klasifikuese, por janë të licencuara dhe mbikëqyrura nga regjime mbikëqyrëse të barasvlefshme me Regjimin Aftësia Pagueuse II të Bashkimit Evropian.
- c) Niveli i Cilësisë së Kreditit do të jetë i fiksuar në 5 (pesë) për shoqëritë e risigurimit që nuk kanë Shkallë Krediti, ose nuk janë subjekt i regjimeve mbikëqyrëse të barasvlefshme me Aftësinë Pagueuse II.

2. Konvertimi i Shkallës së Kreditit ose Raportit të Aftësisë Pagueuse të shoqërive të risigurimit në Nivelin përkatës të Cilësisë së Kreditit, përcaktohet në Aneksin 1, të kësaj rregulloreje. Pjesë përbërëse e kësaj rregullore është edhe Aneksi 2, referencat orientuese, në të cilën shoqëritë e sigurimit marrin informacion mbi gjendjen financiare të shoqërive të risigurimit.

Neni 5

Kriteret e pjesëmarrjes së shoqërive të risigurimit në kontratat e risigurimit

1. Shoqëritë e sigurimit, në përzgjedhjen e shoqërive të risigurimit pjesëmarrëse në marrëveshjet e Risigurimit, të zbatojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) Shoqëritë e risigurimit nuk duhet të jenë në proces likuidimi apo falimentimi;
 - b) Niveli i Cilësisë së Kreditit nuk duhet të jetë më i lartë se 3 (tre) për:
 - i. Risiguruesit kryesorë të marrëveshjeve të risigurimit;
 - ii. Shoqëritë e risigurimit që marrin pjesë në shtresat e palimituara të marrëveshjeve të risigurimit.
 - c) Çdo shoqëri risigurimi me Nivel të Cilësisë së Kreditit 4 (katër) ose më të lartë mund të marrë pjesë me:
 - i. Jo më shumë se 10% të totalit në marrëveshjen proporcionale të risigurimit;

- ii. Jo më shumë se 10% të totalit të çdo shtrese të kufizuar të marrëveshjes jo-proporcionale të risigurimit.

ç) Pjesëmarrja e të gjitha shoqërive të risigurimit me Nivel të Cilësisë së Kreditit 4 (katër) ose më të lartë nuk mund të kalojnë:

- i. 20% të totalit në çdo marrëveshje proporcionale të risigurimit;
- ii. 20% të totalit të çdo shtrese të kufizuar të një marrëveshjeje jo-proporcionale të risigurimit.

d) Për çdo rrezik që mbulohet nga marrëveshja e risigurimit, shuma e risiguruar nga një shoqëri risigurimi me Nivel të Cilësisë së Kreditit 4 (katër) ose më të lartë, nuk mund të kalojë 10 % të kapitaleve të veta të shoqërisë së risigurimit.

2. Shoqëritë e risigurimit që marrin pjesë në kontratat fakultative të risigurimit të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) Risigurimet me shuma të pakufizuara duhet të kryhen me shoqëri risigurimi me Nivel të Cilësisë së Kreditit jo më të lartë se 3 (tre);
- b) Shoqëritë e risigurimit me Nivel të Cilësisë së Kreditit 4 (katër) ose më të lartë, duhet të ndjekin kriteret e përcaktuara në pikat c dhe ç të pikës 1 të këtij neni.

3. Para përfshirjes së shoqërive të risigurimit, të cilat nuk janë të klasifikuara nga një prej agjencive klasifikuese sipas nenit 4, pika 1, gërma a), të kësaj rregullore ose me Nivel të Cilësisë së Kreditit 4 (katër) ose më të lartë, në një marrëveshje apo kontratë fakultative të risigurimit, shoqëria e sigurimit duhet të sigurojë dhe të depozitojë në Autoritet informacion të besueshëm për gjendjen financiare të shoqërisë së risigurimit, përfshirë raportin e pasqyrave financiare të audituara të shoqërisë së risigurimit për vitin e fundit financiar.

Neni 6

Shqyrtimi i kontratës të risigurimit

1. Autoriteti pas shqyrtimit të kontratës së risigurimit, kur gjykon që një ose disa shoqëri risiguruese të kontraktuara nga shoqëria e sigurimit nuk përmbushin kriteret e parashikuara në këtë rregullore, i kërkon shoqërisë së sigurimit të bëjë ndryshime në kontratën e risigurimit të shoqërisë, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje.
2. Shoqëria e sigurimit ka përgjegjësinë të depozitojë pranë Autoritetit informacionin e nevojshëm për gjendjen financiare si dhe planin e masave lidhur me zbutjen e përkeqësimit të rrezikut të kreditit që mund të ndodhë përpara se shoqëritë e risigurimit të kenë përmbushur plotësisht detyrimet që lindin nga kontrata e risigurimit. Shoqëria e sigurimit zbaton planin e masave pas miratimit të tij nga Autoriteti.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Aneksi 1: Përcaktimi i Nivelit të Cilësisë së Kreditit¹

Niveli i Cilësisë së Kreditit	Shoqëria e risigurimit						Shpjegimi i Nivelit të Cilësisë së Kreditit
	Me shkallë krediti të vlerësuar prej agjencive klasifikuese				Pa shkallë krediti, por të licensuar dhe mbikëqyrur nga regjime mbikëqyrëse të barasvlefshme me Aftësinë Paguese II të Bashkimit European	Pa shkallë krediti dhe të pa licensuar e mbikëqyrur nga regjime mbikëqyrëse të barasvlefshme me Aftësinë Paguese II të Bashkimit European	
	S & P	Moody's	Fitch	AMBest	Raporti i Aftësisë Paguese		
0	AAA	Aaa	AAA	aaa		N/A	Shoqëria e risigurimit ka kapacitet tepër të lartë për të përmbushur detyrimet financiare si dhe vlerësohet me rrezik minimal krediti.
1	AA	Aa	AA	aa	196% ose më shumë	N/A	Shoqëria e risigurimit ka kapacitet shumë të lartë për të përmbushur detyrimet financiare dhe vlerësohet me rrezik të ulët krediti.
2	A	A	A	a	≥ 175% dhe < 196%	N/A	Shoqëria e risigurimit ka kapacitet të lartë për të përmbushur detyrimet financiare dhe vlerësohet me rrezik të ulët krediti, por mund të ndikohet më tepër nga efektet negative prej ndryshimeve të tregjeve dhe ambientit ekonomik krahasuar me shoqëritë e risigurimit të klasifikuara në Nivelin 1 të Cilësisë së Kreditit.
3	BBB	Baa	BBB	bbb	≥ 122% dhe < 175%	N/A	Shoqëria e risigurimit ka kapacitet të përshtatshëm për të përmbushur detyrimet financiare dhe vlerësohet me rrezik të moderuar të kreditit. Megjithatë, efektet negative prej ndryshimeve të tregjeve dhe ambientit ekonomik mund të cojnë në dobësimin e kapacitetit në përmbushjen e detyrimeve financiare.
4	BB	Ba	BB	bb	≥ 100% dhe < 122%	N/A	Shoqëria e risigurimit ka kapacitet për të përmbushur detyrimet financiare, por vlerësohet me rrezik të konsiderueshëm të kreditit. Pasiguria e vazhdueshme dhe ekspozimi ndaj përkeqësimit të biznesit, kushteve financiare dhe ekonomike, mund të cojnë në kapacitet të pamjaftueshëm për të përmbushur detyrimet financiare.
	B	B	B	b	≥ 95% dhe < 100%	N/A	Shoqëria e risigurimit ka kapacitet për të përmbushur detyrimet financiare, por vlerësohet me rrezik të lartë të kreditit. Përkeqësimi i biznesit, kushteve financiare dhe ekonomike rrit mundësinë e dërgimit në kapacitet apo vullnet të pamjaftueshëm për të përmbushur detyrimet financiare.
5	<B	<B	<B	<b	≥ 75% dhe < 95%	Shoqëritë e risigurimit pa shkallë krediti, të pa mbikëqyrura nga regjime mbikëqyrëse të barasvlefshme me Regjimin Aftësie Paguese II do të klasifikohen në nivelin 5 të Cilësisë së Kreditit	Shoqëria e risigurimit është aktualisht e dobët ose shumë e dobët financiarisht dhe me rrezik shumë të lartë krediti, përfshirë pa aftësinë paguese. Përmbushja e detyrimeve mundësohet nga kushtet e favorshme të biznesit, financiare dhe ekonomike.
					më i ulët se 75%		

¹ Tabela mund të jetë subjekt i ndryshimeve

Aneksi 2: Referenca orientuese²

- Directive 138/2009/EC
<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32009L0138&from=EN>
- Technical Standards on the allocation of credit assessments of ECAIs to an objective scale of credit quality steps
[https://eiopa.europa.eu/Publications/Consultations/JC%20CP%202015%20001%20\(Joint%20CP%20on%20draft%20ITS%20on%20mapping%20of%20ECAIs%20under%20SII\).pdf#search=probability%20of%20default%20and%20credit%20assessment](https://eiopa.europa.eu/Publications/Consultations/JC%20CP%202015%20001%20(Joint%20CP%20on%20draft%20ITS%20on%20mapping%20of%20ECAIs%20under%20SII).pdf#search=probability%20of%20default%20and%20credit%20assessment)
- Technical specifications for the preparatory phase (EIOPA -14/209) -30 April 2014
<http://archive.eiopa.europa.eu/publications/technical-specifications/index.html>
- Insurance: European Commission adopts a first package of third country equivalence decisions under Solvency II
http://europa.eu/rapid/press-release_IP-15-5126_en.htm
- COMMISSION DELEGATED DECISION (EU) of 5.6.2015 on the equivalence of the solvency and prudential regime for insurance and reinsurance undertakings in force in Sëitserland based on Articles 172 (2), 227(4) and 260(3) of Directive 2009/138/EC of the European Parliament and of the Council
http://ec.europa.eu/finance/insurance/docs/solvency/international/delegated-act-c-2015-3754_en.pdf

² Lista e referencave orientuese mund të jetë subjekt i ndryshimeve